



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
(RTSH) PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e shprehjes së interesave të publikut dhe rifitimin e besimit të tij te ky transmetues;

- Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, të cilat pasqyrojnë te dëgjuesit dhe shikuesit e të gjitha moshave larminë e jetës shqiptare;

- Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm të lajmeve të vendit dhe të atyre ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e RTSH-së për vitin 2018 në drejtim të:

- Transformimit të të gjitha programeve të RTSH-së, në formë dhe në përmbajtje, duke sjellë një frymë të re në televizion, bazuar në standardet europiane. Ndërtimit të një platforme komunikimi të suksesshme që ka bërë të mundur rritjen e ndjeshme të audiencës, në veçanti për ndjekjen e eventit të Kupës së Botës Rusi 2018 dhe aplikacionit RTSH TANI.

- Futjes së kanaleve dhe programe të reja me interes të lartë për kategoritë e ndryshme të qytetarëve dhe fushave të ndryshme sociale dhe të kulturës, siç është dhe nisja e transmetimeve në kanalin e dytë gjeneralist, të lajmeve në gjuhët e minoriteteve. Në vitin 2018 transmetimet në këtë kanal janë shtrirë edhe në gjuhën maqedonase, vllahe dhe për herë të parë në gjuhën rome, duke bërë të mundur pasqyrimin në kohë reale të problematikave të këtyre komuniteteve.

- Mirëmenaxhimit të hapësirave publicitare dhe njoftimeve në Televizionin Shqiptar, Radio Tiranën, në faqen WEB, si dhe sponsorizimi i programeve të ndryshme e shitja e të drejtave të transmetimit të programeve të RTSH-së. Gjatë vitit 2018, RTSH ka lidhur me

subjekte të ndryshme në total 83 kontrata, nga të cilat janë lidhur 35 për *FIFA World Cup* dhe 9 kontrata për shitjen e *Highlights* për këtë event, duke sjellë një rritje prej 168 % të të ardhurave nga kjo kategori në krahasim me ato të realizuara në vitin 2017.

- Plotësimi të kuadrit rregullator të brendshëm, me qëllim mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit, siç janë dhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve të brendshme të secilës drejtori dhe njësi, si dhe paketës së re të tarifave të publicitetit për të gjitha kanalet e paketës digjitale të RTSH-së.

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, ku mund të veçojmë nënshkrimin e marrëveshjeve të shumta të ritransmetimit të programeve të RTSH-së me dhjetëra operatorë të ndryshëm kabllorë në të gjithë Shqipërinë, nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me RAI-n, pjesëmarrjen në *Copeam Coproduction Inter-Rives 6*, pjesëmarrjen në *Eurovision Song Contest 2018*, në *Eurovision Young Musician*, në *Junior Eurovision Song Contest*, si dhe organizimi për herë të parë në Shqipëri të Asamblesë së Përgjithshme të *European Broadcasting Union*, e cila u mbajt në Tiranë, në qershor 2018.

- Futjes së zhvillimeve të fundit teknologjike në gjithë linjën e prodhimit dhe të transmetimeve për ndryshimin e teknologjisë së prodhimit nga teknologjia me definicion standard në atë me definicion të lartë, si dhe arkivimin digjital të aseteve të RTSH-së.

- Ndërhyrjen për përmirësimin e pajisjeve të transmetimit në studiot televizive dhe radio të Qendrave Vendore Audiovizive.

Kuvendi kërkon që Këshilli Drejtues i RTSH-së dhe RTSH, për vitin 2019, të përmirësojnë punën në këto drejtime:

- Të bëhet publikimi i vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli Drejtues dhe organet e këshillat e tjerë të RTSH-së, në funksion të transparencës dhe informimit, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

- Në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv, të përfundojë ndërtimi i rrjetit numerik të shpërndarjes së sinjalit, duke bërë të mundur mbylljen e transmetimeve analoge në të gjithë Shqipërinë dhe kjo të shoqërohet me rritjen e të ardhurave që rrjedhin nga shfrytëzimi i rrjetit numerik të transmetimit.

- Të përshpejtohen ritmet e punës për digjitalizimin e materialeve arkivore dhe të kompletohet brenda vitit 2019 ndërtimi i rrjetit numerik të shpërndarjes DVB T2 të RTSH-së.

- Të vijojë puna për rinovimin e teknologjisë së prodhimit të programeve, duke bërë përpjekje për modernizimin e teknologjisë në Qendrat Vendore Audiovizive.

- Të përmbushen detyrimet e parashikuara në Kontratën e Shërbimit të Transmetimit Publik për fillimin e transmetimit të kanaleve dhe programeve të reja, të cilat në raportin vjetor të AMA-s rezultojnë si detyrime të papërmbushura.

- Të mirëmenaxhojë asetet në dispozicion të RTSH-së, pa krijuar hapësira për keqpërdorim apo abuzim të përdorimit të këtyre aseteve.

- Të vendosë standarde më profesionale në aprovimin e projekteve, bazuar në kriterin e detyrimit ligjor dhe gjithëpërfshirës, kriterin e cilësisë artistike e kriterin e personalitetit të krijuesit, si dhe t'i bëjë transparente këto procedura nëpërmjet paraqitjes së informacionit të hollësishëm në raportin vjetor.

- Të intensifikojë përpjekjet për të bashkëpunuar me të gjithë aktorët e interesuar në tregun e medias audiovizive për të bërë të mundur kryerjen e një matjeje sa më profesionale të audiencës.

- Të prodhojë programe të larmishme që synojnë jo vetëm përmbushjen e deklaratës së qëllimit, por edhe që sjellin konkurrencë në tregun e medias audiovizive dhe rritjen e besimit të transmetuesit i tyre, me fokus të veçantë programet edukuese.

- Të intensifikojë punën me organet e Kuvendit për përfshirjen në transmetim të të gjithë veprimtarisë së institucionit, duke përfshirë mbledhjet e komisioneve, nënkomisioneve dhe aktiviteteve të ndryshme parlamentare, në kanalën RTSH KUVEND, si dhe të sigurohet transmetimi në gjuhën e shenjave për këtë kanal.

- Të vijojë prodhimin dhe transmetimin e programeve që i kushtohen proceseve integruese të vendit, në kuadër të çeljes së negociatave me Bashkimin Europian.

- Të përdorë të ardhurat e realizuara kryesisht për prodhimin e programeve cilësore dhe rritjen e larmishmërisë së tyre, duke u dhënë përparësi programeve të përgatitura nga prodhuesit e pavarur dhe rritjen e fondit të rezervuar për ta.

- Të pasqyrojë në raportin vjetor një përshkrim të detajuar për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur dhe efektshmërinë e këtij fondi.

- Të marrë masa për rishikimin e faqes së internetit, në përputhje me parimin e transparencës së veprimtarisë, si dhe shtimin e shërbimeve në internet dhe rritjen e pjesëmarrjes në rrjetet sociale.

- Të përfundojë procesin e hartimit të Strategjisë së Zhvillimit, si dhe t'i publikojë në fillim të çdo viti planin e biznesit, si dhe çdo 6 muaj situatën financiare dhe matjen e audiencës së RTSH-së, këto informacione t'i bëjë pjesë të raportit vjetor të veprimtarisë.

- Të forcojë kapacitetet administrative të stafit të institucioni, ku domosdoshmëria për trajnim duhet të shtrihet në shumë departamente të tjera si në teknikë, montazh.

Kuvendi i kërkon Qeverisë që për vitin 2019 e në vijim:

- Të ketë në vëmendje zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së, për të siguruar mbështetjen e domosdoshme financiare, që garanton autonominë institucionale dhe pavarësinë editoriale, si dhe të synojë financimin e domosdoshëm për të bërë të mundur kryerjen e shërbimit publik në fushën e medias audiovizive nga RTSH-ja.

Miraturar në datën 25.4.2019